



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 411/6 prot.

Tiranë, më 17.04.2026

**REKOMANDIM**

**Nr. 20, datë 17.04.2026**

**PËR KONTROLLUESIN “KRON CONSTRUCTION” SHPK**

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Kron Construction” shpk (në vijim, “Kontrolluesi”),

**KONSTATOHET SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 28, datë 6.2.2026 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M118090055J me objekt aktiviteti: “Projektim dhe zbatim si kontraktor /nëkontraktor në fushën e ndërtimit, ndërtime civile – industriale, rikonstruksione, mirëmbajtje ndërtesash, etj.”

Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e të dhënave “punonjës”, “klientë”, “vizitorë” etj. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi grumbullon në arkivin fizik dokumentacionin për personelin aktual dhe të larguar. Nga verifikimi i dosjeve të vendosura në dispozicion, rezulton se, në dosjet e personelit të larguar ruhen, ndër të tjera, kopje të: “vërtetim i gjendjes gjyqësore”; “certifikatë personale”; “certifikatë familjare”; “jetëshkrim”; “letërnjoftim” “kartelë shëndetësore e punëmarrësit dhe vlerësimi të riskut”, etj. Gjithashtu, në adresën elektronike të punonjësit përgjegjës të burimeve njerëzore rezulton se, vijojnë të ruhen kopje të jetëshkrimit të kandidatëve, që kanë aplikuar për pozicionet e shpallura vakante, edhe pas përfundimit të procedurës së konkurrimit (datë 6.03.2025).

Për sa më sipër rezulton se, të dhënat e mbledhura nga Kontrolluesi ruhen pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit, që nënkupton se të dhënat personale mbahen në një formë që lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për një periudhë jo më të gjatë se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato përpunohen, si dhe nuk janë parashikuar rregulla specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave për shëndetin, si kategori e të dhënave sensitive, sipas parashikimeve në Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar afatet e ruajtjes për çdo kategori të dhënash personale, duke marrë në konsideratë, qëllimin e përpunimit, bazën ligjore përkatëse, detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni sektorial, si dhe nevojën për ruajtje për qëllime të mbrojtjes së të drejtave ligjore apo për përmbushjen e detyrimeve kontraktore. Afatet duhet të jenë proporcionale dhe të justifikuara, duke shmangur ruajtjen e të dhënave për një kohë të pacaktuar, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit.

Gjithashtu, Kontrolluesi duhet të hartojë procedura të qarta për fshirjen, asgjësimin ose anonimizimin e të dhënave personale pas përfundimit të afatit të ruajtjes, si dhe mekanizma monitorimi dhe auditimi të brendshëm për të garantuar zbatimin efektiv të këtyre afateve. Në rastet kur të dhënat ruhen për periudha më të gjata për qëllime arkivore në interes publik, për qëllime kërkimore apo statistikore, duhet të aplikohen masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të garantuar minimizimin e të dhënave dhe kufizimin e aksesit.

Kontrolluesi, gjatë proceseve përpunuese duhet të vlerësojë edhe përputhshmërinë me parimin e minimizimit të të dhënave, në kuptim të mbledhjes dhe përpunimit vetëm të atyre të dhënave që janë të përshtatshme, përkatëse dhe të domosdoshme në raport me qëllimin e përpunimit. Në këtë kuadër, duhet të analizohet nëse kërkimi i

vërtetimit të gjendjes gjyqësore është i justifikuar në çdo rast, pasi jo në të gjitha pozicionet e punës një e tillë është e nevojshme dhe proporcionale.

3. Kontrolluesi nuk ka publikuar “*Politikat e Privatësisë*” në faqen zyrtare të internetit [kronconstruction.al](http://kronconstruction.al). Subjektet e të dhënave nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të dhënat e kontaktit të përfaqësuesit të Kontrolluesit, si dhe nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave të Kontrolluesit, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (për akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, faqja zyrtare e internetit përbën zakonisht pikën e parë të kontaktit ndërmjet Kontrolluesit dhe subjektit të të dhënave, ndaj mungesa e një politike ose publikimi i saj në mënyrë jo të plotë kufizon informacionin e nevojshëm ndaj subjekteve mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale.

Gjithashtu, publikimi i rubrikës “*Politikat e Privatësisë*” është thelbësor për ushtrimin efektiv të të drejtave të subjekteve të të dhënave. Vetëm përmes informimit të plotë sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit, subjektet e të dhënave mund të njihen me të drejtat e tyre dhe me mënyrën për t’i ushtruar ato, duke shmangur situatat ku këto të drejta mbeten formale dhe të pazbatueshme në praktikë. Njëkohësisht, ato shërbejnë si mjet parandalues ndaj praktikave jo ligjore ose të njëanshme të Kontrolluesit gjatë përpunimit të të dhënave personale.

4. Rezulton se, për kategoritë e të dhënave sensitive (të dhëna biometrike) të subjekteve të të dhënave që trajtohen nga Kontrolluesi në sistemet e “*hyrje-daljeve*”, nuk janë hartuar rregulla dhe procedura organizative specifike, mbi mënyrën e përpunimit të tyre, sigurinë, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., si një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 28 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Të dhënat biometrike të administruara për qëllim të identifikimit të punonjësve, ruhen në ambiente jo të përshtatshme, duke mos marrë, midis të tjerash, masa organizative dhe fizike, si një kategori e veçantë, të cilës duhet t’i sigurohet mbrojtje e dyfishtë dhe vëmendje e shtuar për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e tyre, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 11.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi duhet të marrë masa sigurie, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, sigurimin e ambienteve ku administrohen të dhëna sensitive, kufizimin e aksesit vetëm për persona të autorizuar, si dhe eliminimin e çdo elementi që mundëson ekspozimin e të dhënave nga jashtë këtyre ambienteve.

Gjithashtu, Kontrolluesi duhet të parashikojë rregulla/politika dhe të marrë masa konkrete tekniko-organizative, në mënyrë që të mbrohen sistemet e regjistrimit, mënyrat e transferimit dhe mjetet transmetuese në të cilat gjenden të dhëna sensitive, nga aksesimi i paautorizuar apo aksidental, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar. Për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme, Kontrolluesi duhet të hartojë rregulla dhe procedura organizative specifike për këtë kategori të të dhënave personale, në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e tyre, në përputhje me nenet 9 dhe 28 të Ligjit.

5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion, rezulton se, Kontrolluesi nuk disponon “*Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e të dhënave personale në kundërshtim me nenin 27 dhe 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të tij.

Megjithatë, në vijim të hetimit administrativ, Kontrolluesi ka hartuar dhe përcjellë Rregulloren për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nga analizimi i përmbajtjes së Rregullores rezulton se ajo i referohet modelit tip të miratuar nga Komisioneri dhe nuk parashikon rregulla specifike mbi kategoritë e të dhënave personale, përfshirë të dhënat sensitive, mënyrën e përpunimit të të dhënave, sigurinë e të dhënave personale, konfidencialitetin, aksesin në të dhënat personale, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj., sipas parashikimeve të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese që kryen.

Zyra e Komisionerit vlerëson se përshtatja dhe plotësimi i rregullores “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, me të gjithë elementët ligjorë të përcaktuar në pikën 1 të nenit 27 të Ligjit, konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Gjithashtu, në rregullore duhet të përcaktohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura organizative për të gjitha aspektet e përpunimit të të dhënave, duke përfshirë, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë fizike, teknike dhe administrative, ruajtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave, aksesin, si dhe afatet e ruajtjes së të dhënave.

6. Konstatohet se, Kontrolluesi e ka deleguar shërbimin e mirëmbajtjes së faqes zyrtare [kronconstruction.al](http://kronconstruction.al) tek një palë e jashtme. Megjithatë, Kontrolluesi nuk ka lidhur një marrëveshje, në të cilën të specifikohen masat konkrete tekniko-organizative të detyrueshme për t’u zbatuar nga ana e përpunuesit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit “*Mbi rregullimin e*

*marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 19”).*

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo delegim i përpunimit të të dhënave personale duhet të realizohet përmes një kontrate/marrëveshje të shkruar dhe të detajuar, e cila përcakton qëllimin e përpunimit, kategoritë e të dhënave, masat e sigurisë që do të zbatohet përpunuesi, përgjegjësitë ligjore dhe procedurat për kontrollin dhe raportimin. Kjo siguron që delegimi të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 26 të Ligjit.

7. Rezulton se, Kontrolluesi nuk ka marrë masat e duhura teknike dhe organizative për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm ndaj rrezikut, duke përfshirë, ndër të tjera, *pseudonimizimin dhe enkriptimin e të dhënave personale; aftësinë për të garantuar konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e sistemeve dhe të shërbimeve të përpunimit; aftësinë për të rivendosur disponueshmërinë dhe aksesin në të dhënat personale brenda një kohe të arsyeshme në rast incidenti fizik ose teknik; një proces për testimin, shqyrtimin dhe vlerësimin e rregullt të efikasitetit të masave teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë e përpunimit* etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6, datë 05.08.2013 të Komisionerit “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*” (në vijim, “*Vendimi nr. 6*”).

Kontrolluesi, për shkak të veprimtarisë së tij, nuk ka marrë masa për të krijuar, zbatuar, mirëmbajtur dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme një Sistem Menaxhimi të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System “PIMS”*), sipas Udhëzimit nr. 09, datë 20.11.2025 “*Për kriteret e përgjithshme për certifikimin dhe për dhënien e vulave dhe të shenjave të mbrojtjes së të dhënave personale*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 09*”).

Gjithashtu, konstatohet se Kontrolluesi nuk mban dokumentacion mbi veprimtaritë e përpunimit, me qëllim demonstrimin e përputhshmërisë me Ligjin, në formë të shkruar dhe në format elektronik, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit.

Kuadri ligjor evropian mbi mbrojtjen e të dhënave personale, të cilin Ligji transponon dhe praktika më e mirë evropiane, e konsideron certifikimin si një mekanizëm përputhshmërie me Ligjin<sup>1</sup> dhe për të inkurajuar zbatimin e tij, i krijon rast pas rasti kontrolluesve që e zbatojnë atë në mënyrë efektive, një pozitë preferenciale në kryerjen e disa veprimtarive përpunuese të caktuara siç janë për shembull transferimet ndërkombëtare. Në zbatim të nenit 37 të Ligjit, Komisioneri ka miratuar Udhëzimin nr. 08 datë 20.11.2025 “*Për kriteret shtesë për akreditimin e organizmave certifikues*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 08*”) dhe Udhëzimin nr. 09.

<sup>1</sup> Pika 3 e nenit 22, pika 3 e nenit 28

Udhëzimi nr. 09 referon në Sistemet e Menaxhimit të të Dhënave Personale (*Privacy Information Management System "PIMS"*) dhe Komisioneri inkurajon kontrolluesit të cilët për shkak të natyrës së veprimitarisë së tyre e kanë të nevojshëm ngritjen e një sistemi të tillë me qëllim standardizimin dhe rregullimin e veprimitarisë përpunuese dhe garantimin e sigurisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatimin e Udhëzimit nr. 08 dhe nr. 09.

Në rastin konkret, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veprimitarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi duhet të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë një sistem menaxhimi të të dhënave personale (PIMS) në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 09.

Bazuar në nenin 28 të Ligjit dhe nenin 13 të Udhëzimit nr. 09, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete teknike dhe organizative që garantojnë nivel të përshtatshëm për rrezikun, masa të cilat duhet të rishikohen në mënyrë periodike për të siguruar efektivitet të vazhdueshëm.

8. Nga verifikimi on-site i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit, si dhe nga shqyrtimi i procedurave rregulluese të Kontrolluesit, rezulton se:

- Kontrolluesi nuk ka hartuar dhe miratuar plane të dokumentuara për menaxhimin e riskut, përfshirë identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve që lidhen me përpunimin e të dhënave personale, si dhe nuk ka përcaktuar teknikat dhe mekanizmat përkatës të menaxhimit dhe monitorimit të performancës së masave të sigurisë, në kundërshtim me detyrimin për të garantuar një nivel sigurie të përshtatshëm sipas parimit të llogaridhënies;
- Nuk ka të hartuar planin e politikave të vazhdueshmërisë së biznesit, dokumente këto që do të duhet të përmbanin politikat dhe objektivat që sigurojnë vijueshmërinë e punës;
- Nuk ka të specifikuar/dokumentuar kohën maksimale në të cilën shërbimet dhe sistemet nuk mund të jenë funksionale. Nuk janë planifikuar masa që në rast dështimi të një/disa pajisjeve të mos ndikohet në funksionimin e sistemeve dhe shërbimeve të ofruara;
- Nuk ka kryer auditime të brendshme me qëllim garantimin e mirëfunksionimit të këtyre teknikave për menaxhimin e riskut (ose në mungesë të teknikave, identifikim të riskut);
- Politikat mbi gjurmët (log-et) për infrastrukturën mbështetëse TIK, nuk zbatohen sipas një procedure të rregulluar, me risk në qasje të paautorizuar në të dhëna, kërcënim të sigurisë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe mungesë transparence.

Gjithashtu, konstatohet se masat e ndërmarra në drejtim të backup-it janë të pamjaftueshme dhe nuk japin siguri në mbështetjen e planit të vazhdueshmërisë së

biznesit (BCP) dhe planit të rimëkëmbjes nga katastrofa (DRP), në kundërshtim kjo me masat e sigurisë së informacionit. Nuk u gjetën procedurat e rikrijimit (restore) të backup-it të të dhënave me qëllim testimin e tyre për t'u siguruar që ato janë të efektshme dhe që mund të ekzekutohen brenda kohës së lejuar. Këto procedura duhet të testohen rregullisht, sistematikisht dhe vazhdimisht.

Për sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht në këtë rast kur përpunimi i të dhënave kryhet nëpërmjet komunikimeve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, mungesa e një plani të strukturuar për menaxhimin e riskut, e reflektuar në mos hartimin e procedurave për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e rreziqeve, si dhe në mungesën e auditimeve të brendshme dhe monitorimit të vazhdueshëm të masave të sigurisë, cenon drejtpërdrejt parimin e llogaridhënies sipas nenit 6 dhe detyrimet e nenit 28 të Ligjit. Pa një analizë të bazuar në risk, Kontrolluesi nuk është në gjendje të përcaktojë masa të përshtatshme teknike dhe organizative, duke krijuar ekspozim të lartë ndaj incidenteve të sigurisë, aksesit të paautorizuar dhe përpunimeve të paligjshme të të dhënave personale.

Në të njëjtën kohë, mungesa e planeve të vazhdueshmërisë së biznesit (BCP) dhe e planeve të rikuperimit nga katastrofat (DRP), si dhe mos përcaktimi i parametrave kritikë, si koha maksimale e ndërprerjes së shërbimeve (RTO/RPO), tregojnë një mungesë të planifikimit për garantimin e disponueshmërisë dhe integritetit të të dhënave. Këto mangësi rrisin ndjeshëm rrezikun që, në rast dështimi teknik apo incidenti kibernetik, të dhënat personale të mos rikuperohen brenda një afati të pranueshëm ose të humbasin në mënyrë të pakthyeshme, duke cenuar të drejtat dhe interesat e subjekteve të të dhënave.

Gjithashtu, mungesa e procedurave të rregulluara për administrimin e log-eve dhe pamjaftueshmëria e masave të backup-it, e shoqëruar me mungesën e testimin të rregullt të rikthimit të të dhënave (restore), tregon se masat e sigurisë janë të paplota dhe jo efektive në praktikë. Në këto kushte, Kontrolluesi nuk garanton gjurmueshmërinë e veprimeve mbi të dhënat, transparencën dhe aftësinë për të reaguar ndaj incidenteve, duke qenë në kundërshtim me kërkesat e nenit 28 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

9. Kontrolluesi ka të instaluar sistemin e video-survejimit (CCTV), përmes së cilit kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme ku ushtron veprimtarinë e tij, për qëllim të mbrojtjes së pronës dhe sigurinë e kontrollit mbi hyrjet dhe daljet.

Nga verifikimet e kryera në datën 13.02.2026, në sistemin e video-survejjimit (CCTV), rezulton se të dhënat imazhe/video, ruhen përtej afatit 30 ditor, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3, datë 30.4.2025 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video survejjimit” (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video-survejjimit CCTV. Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “*imazhe*” e “*video*”, janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se periudha e mbajtjes së të dhënave nuk duhet të kalojë kufirin maksimal të afatit të lejuar, për përmbushjen e qëllimit të video-survejjimit. Të dhënat e mbajtura me anë të sistemit të video-survejjimit duhet të ruhen për një periudhë jo më të gjatë se 30 ditë, dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar duhet të realizohet shkatërrimi i të dhënave imazhe/video, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Nga verifikimi në vend i sistemit të video-survejjimit (CCTV), si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video-survejjimit, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, etj.

Për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi është i detyruar të hartojë rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave, etj., nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV), në përputhje me parashikimet e nenit 28 të Ligjit.

10. Konstatohet se, aktivitetet kryesore të Kontrolluesit janë procese përpunimi, të cilat, për shkak të natyrës, fushës së zbatimit ose qëllimeve të tyre, kërkojnë monitorim të rregullt e sistematik të subjekteve të të dhënave në një shkallë të gjerë.

Kontrolluesi nuk ka emëruar një nëpunës të mbrojtjes së të dhënave personale, në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit. Megjithatë, pas marrjes dijeni për Urdhrin e hetimit administrativ, Kontrolluesi ka emëruar me aktin e emërimit të datës 13.02.2026, personin përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale (DPO).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, caktimi i një nëpunësi për mbrojtjen e të dhënave personale, është një detyrim i rëndësishëm që ka për qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale gjatë proceseve përpunuese, që realizohen nga ana e Kontrolluesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Gjithashtu, bazuar në pikën 3, të nenit 34 të Ligjit, Kontrolluesi ka detyrimin për të publikuar të dhënat e nëpunësit të mbrojtjes së të dhënave, në mënyrë që subjektet e të dhënave të mund ta kontaktojnë atë, për të gjitha çështjet që lidhen me përpunimin e të dhënave të tyre personale dhe ushtrimin e të drejtave të tyre sipas këtij ligji, si dhe për t'ia njoftuar ato Zyrës së Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit në rrugë postare dhe në formë elektronike.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, është paraqitur në seancën dëgjimore, të datës 18.03.2026, të organizuar nga Zyra e Komisionerit, gjatë të cilës ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si dhe bashkëpunimin me Komisionerin për të siguruar që çdo mangësi të adresohet në përputhje me Ligjin.

Gjithashtu, nga ana e Kontrolluesit, me email-in e datës 19.03.2026, protokolluar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 411/5 prot., datë 19.03.2026, është përcjellë dokumentacioni me planin e brendshëm, në funksion të përmbushjes së detyrimeve të Ligjit dhe masat e marra, i cili përfshin aktet e mëposhtme:

- Planin e evakuimit në rast emergjence (EEP), i cili përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e Kontrolluesit, opsionet e evakuimit, trajnimet dhe dokumentacionin, udhëzime të përgjithshme dhe stafin përgjegjës;
- Kodin e sjelljes, i cili parashikon qëllimin, fushën e zbatimit, detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësit, dokumente të lidhura të tilla si: politikat SMSI, marrëveshjet e konfidencialitetit, procedurat e brendshme, politikat HSE, etj.;
- Politikat e përdorimit të pranueshëm të teknologjisë së informacionit, i cili përcakton qëllimin, përgjegjësitë, si dhe parashikime mbi informacionin konfidencial dhe masat e sigurisë;
- Kodin e etikës së biznesit, nëpërmjet të cilit parashikohet angazhimi i Kontrolluesit për ushtrimin e përgjegjshëm të veprimtarisë, si dhe masat për mbrojtjen e informacionit;
- Manualin e sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit, i cili përmban politikat e sigurisë së informacionit, rolet dhe përgjegjësitë, si dhe planin e trajtimit të rrezikut dhe deklaratën e zbatueshmërisë;

- Planin e vazhdimësisë së biznesit (BCP), i cili përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të vazhdimësisë së biznesit (BCC), dokumentacionin e vazhdimësisë, etj.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 6, 13, 27, 28, 34, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit, Komisioneri,

### **REKOMANDON:**

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjithë proceset e përpunimit, në përputhje me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
2. Kontrolluesi, të marrë masa për të publikuar rubrikën “*Politikat e Privatësisë*”, në faqen e internetit [kronconstruction.al](http://kronconstruction.al), me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
3. Kontrolluesi të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e rregullave të brendshme mbi trajtimin, aksesin dhe shpërndarjen e të dhënave sensitive, me qëllim parandalimin e përpunimeve të paautorizuara dhe rritjen e nivelit të sigurisë dhe konfidencialitetit të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 28 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 dhe 28 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e rregullores “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, duke parashikuar në të, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, përcaktimin e niveleve të aksesit etj.;
5. Kontrolluesi, të marrë masa për të hartuar marrëveshjen me përpunuesin, duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas detyrimeve të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19;
6. Kontrolluesi, të marrë masa për caktimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas parashikimeve të neneve 33 dhe 34 të Ligjit, si dhe të njoftojë Zyrën e Komisionerit për caktimin e tij;

7. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:

- (i) vazhdimisht, detyrimet e përcaktuara në pikat 1 dhe 3 më sipër;
- (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve detyrimin e përcaktuar në pikën 2 më sipër;
- (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 6 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

8. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve;

9. Komisioneri, bazuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me Ligjin. Në rast të mos zbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 17.04.2026.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**